



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Raporti mujor: Për muajin Maj-2017

**POZICIONI : Basri Hashani, drejtor i DRSK-së**

### 1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1,1 – Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Procedurë	Të Pazgjidhura
11	6	-	5	-

Tabela- 2 Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vrejtje
16	16	116	-	Janë inkasuar 58.00€

Tabela-3 Raport për Biblotekën e Qytetit dhe Bibliotekat në teren

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunimi i librit	Lexus në sallën e leximit
1,231	1,232	177	226	709

- Kemi punuar raportin për muajin Prill.
- Kemi marrë pjesë në punimet Kuvendit (u ndërpre) .
- Komisionet për ndarjen e Subvencioneve për Klubet Sportive dhe për OJQ dhe Shoqata tjera ,ku si anetar të këtyre komisioneve kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të DKRS-se kanë përfunduar punën e tyre dhe njëherit ju kanë drejtuar Kryetarit të Komunes me rekomandime , më pas janë nënshkruar edhe marrëveshjet me Kryetarit dhe përfaqësuesve të Klubeve Sportive dhe OJQ- ve dhe Shoqatave .
- Një pjesë e mirë e këtyre Subvencioneve janë ndarë Klubeve dhe OJQ-ve .
- Një pjesë e Subvencioneve të cilat janë rekomanduar nga Komisioni e vlera e të cilave ka qenë më e lartë se 2,000.00 € (DYMIJË EURO) nuk kanë mundur të ekzekutohen për arsye se duhet Kuvendi i Komunës të marrë vendim .
- Kemi hartuar planin për javën e Kulturës 1-14 qershor dhe kemi bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e këtij projekti ,por ,për shkak të Fushatës zgjedhore jemi detyruar të reduktojmë aktivitetet .kemi inventarizuar me inventarë Bibliotekën e Qytetit dhe atë në Magurë me karriga dhe tavolina për këto dy Biblioteka .
- Kemi marrur pjesë në Tryezë e organizuar nga Asociacioni I Komunave të Kosovës me temën zhvillimi i Atletikës në Kosovë.
- Gjatë muajit Maj kemi marrë pjesë në Festivalin e Instrumentalistëve të vegjël popullorë në Fush -Arrëz të Shqipërisë me një grup instrumentalistësh nga Komuna e Lipjanit ,ku për tre ditë rrjeshtë kemi garuar ku Grupi ynë është shpërblyer me vendin e 3 dhe dhe solisti ERIAD KARPURI është shpërblyer me çmimin Zëri i Artit të Festivalit ,ku ka marrë pjesë edhe një delegacion i komunës në krye me nënk. Z.Sefer Tashollin .
- Në bashkëpunim me Shoqatën Kulturorë Turke „YNUZ EMRE “ kemi organizuar një koncert të Koreve ku kanë marrë pjesë një Kor Turk dhe tre Kore tjera nga Kosova , koncerti është mbajtur në Qendern Kulturorë „Tahir Sinani” në Lipjan .
- Në bashkëpunim me OJQ-të Rinore ,Qendrat Rinore ,KVRL-në dhe nxënësit e Shkollave të mesme,kemi organizuar Aksionin të pastrojmë Kosovën.
- Sektori i Arkivit ka bërë vizitë punë në Arkivin e Komunës, Qendren e Qytetit si dhe në disa Shkolla si : SHFMU Bujan ,Ribar i Madh dhe Poturovc ,ku ka marrë informata lidhur me gjendjen e materialit Arkivor në këto institucione .